



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9615 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TË KOMISIONIT KËSHILLIMOR “PËR
TITUJT VENDORË TË NDERIT, KRITERET DHE PROCEDUREN E DHËNIES
SË TYRE SI DHE EMËRTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE,
INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË
VLORË””**


Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/a dhe b, neni 54 pika a, k, ll dhe m, në Ligjin nr. 112/2013 datë 04.04.2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” neni 17 dhe në vijim, në Ligjin nr.94/2022 datë 22.12.2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr.861 datë 10.02.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Hollëshishme për Funkcionimin e Komisioneve Këshillimore për Dhënien e Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024



VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për Titujt Vendorë të Nderit, Kriteret dhe Proceduren e Dhënies së Tyre si dhe Emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë, Kryetari dhe Sekretariati i Këshillit të Bashkisë si dhe Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9615 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TË KOMISIONIT KËSHILLIMOR “PËR
TITUJT VENDORË TË NDERIT, KRITERET DHE PROCEDUREN E DHËNIES
SË TYRE SI DHE EMËRTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE,
INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË
VLORE”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Anëtarë të Këshillit të Bashkisë

Projektvendimi që ju paraqesim për miratim “Për Miratimin e Rregullores të Komisionit Këshillimor “Për Titujt Vendorë të Nderit, Kriteret dhe Proceduren e Dhënies së tyre si dhe Emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë” lidhet me procedurat dhe vendimmarrjen e Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë. Sikurse jeni në dijeni Komisioni Këshillimor aktualisht nuk ka patur një rregullore të miratuar e cila është e domosdoshme për vendimmarrjen e tij por, edhe të Këshillit të Bashkisë.

Me këtë rregullore është synuar të krijohen disa standarte në vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë gjatë vlerësimit të personaliteteve të shquara me kontribut në nivel lokal dhe kombëtar. Gjithashtu në këtë rregullore synohet që edhe për emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve ose objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë të ndiqet e njëjta procedurë si për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit. Kjo nënkupton që rregullorja nuk kufizohet vetëm në procedurën e dhënies së Titujve Vendorë të Nderit sikurse parashikohet në dispozitat ligjore për ngritjen e Komisionit Këshillimor. Pra, objektivi është që edhe gjatë emërtimit të rrugëve, shesheve, institucioneve etj, para vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë të bëhet një vlerësim paraprak nga Komisioni Këshillimor, pavarësisht se kjo nuk e kufizon vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë.

Në këtë rregullore njëkohësisht është formalizuar edhe dhënia e vlerësimeve për personalitetet e shquara të qytetit nga Kryetari i Bashkisë, në rastet kur vlerësohet se nuk plotësohen kushtet për ti dhënë Titullin Qytetar Nderi i Vlorës.

E rëndësishme në këtë rregullore është edhe përcaktimi i procedurave për përcaktimin e subjekteve të cilët mund të bëjnë propozime për vlerësim, përcaktim i cili nga një aspekt thjeshton procedurën për vendimmarrje por qartëson gjithashtu faktin se propozimi për një titull a medalje nuk është një e drejtë që kërkohen në mënyrë individuale ose nga familjarët, gjë që është e konstatuar nga kërkesat e paraqitura ndër vite pranë Sekretariatit të Këshillit të Bashkisë.


Në këtë rregullore është qartësuar edhe procedura e vendimmarrjes si dhe intepretimin e saj. Nga sa më lartë vlerësojmë se miratimi i kësaj rregulloreje është i domosdoshëm pasi shërben si një dokument udhëzues për procedurat që duhen ndjekur nga Komisioni Këshillimor gjatë vendimmarrjes por edhe ndihmon njëkohësisht vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë.

Në këto kushte kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e këtij projektvendimi, njëkohësisht jemi të gatshëm të reflektojmë Çdo propozim për ndryshim ose plotësim të tekstit të rregullores nga ju të nderuar këshilltarë.

Ju faleminderit

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9615 Prot.

Vlorë, më 18.06.2024

RREGULLORE E KOMISIONIT KËSHILLIMOR TË BASHKISË VLORË

“Për Titujt Vendorë të Nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë”

Neni 1 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë neni 113/1, Ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, pika k, ll dhe m, Ligji nr. 112/2013 datë 04.04.2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 17 e në vijim, Ligji nr. 94/2022, datë 22.12.2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861 datë 10.02.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e “Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 Objekti

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e funksionimit të Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit. Gjithashtu përcaktëton procedurën dhe kriteret për dhënien e titujve vendorë të Nderit si dhe për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë.

Neni 3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i llojeve të titujve të nderit që jepen nga Bashkiak Vlorë si dhe emërtimit të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Titujt e nderit u jepen personave fizik ose juridik vendas ose të huaj, të cilët kanë një kontribut të shquar në dobi të bashkësisë qytetare, në fushat e ndryshme të jetës: historike, kulturore, sportive, muzikore, artistike, humanitare, etj.
2. Dhënia e titujve të nderit, udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.
3. Përfitimi i një titulli nderi nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohet si e tillë, në rrugë individuale.
4. Personi që ka marrë një dekoratë nga Presidenti i Republikës nuk mund të përfitojë më vonë në kohë një titull nderi, medalje apo titull vendor nderi.
5. Kjo rregullore aplikohet për titujt e nderit, dhënia e të cilëve nuk rregullohet me një akt tjetër ligjor.
6. Nuk jepen Tituj Vendorë Nderi personave që kanë qënë bashkëpunëtor të Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Agjenturave të Huaja.
7. Rrugët, sheshet, territoret, institucionet dhe objektet në juridiksionin e Bashkisë Vlorë mund të emërtohen me emra të personaliteteve të shquara në nivel kombëtar e lokal ose të huaja me kontribut në promovimin e interesave të qytetit Vlorë ose të Kombit Shqiptar si dhe ngjarje historike.

Neni 5

Krijimi i Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit

1. Pranë Këshillit të Bashkisë krijohet Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit i përbërë nga 5 anëtarët, nga të cilët 3 anëtarë duhet të jenë punonjës në varësi të Bashkisë Vlorë dhe 2 anëtarë personalitete të shquara jashtë Administratës së Bashkisë.
2. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Këshillimor miratohet me Vendim të Këshillit të Bashkisë sipas parashikimeve në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 si dhe Ligjit nr. 94/2022 datë 22.12.2022.
3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Këshillimor përcaktohet në Rregulloren përkatëse të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Neni 6

Vendimmarrja e Komisionit Këshillimor

1. Mbledhja e Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit është e vlefshme kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit (50% + 1).
2. Vendimet e Komisionit Këshillimor janë të vlefshme kur shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit votojnë pro (50% + 1).
3. Një çështje për të cilën Komisioni Këshillimor voton kundër në një mbledhje të zakonshme, nuk mund të shqyrtohet nga ky Komision brenda një periudhe prej 3 muajsh.

Neni 7

Llojet e titujve vendorë të nderit dhe medaljeve

Titujt vendorë të nderit dhe medaljet jepen nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë respektivisht.

1. Titujt e nderit që jepen nga Këshilli Bashkiak:

a) “Qytetar Nderi i Vlorës”

1. Çdo personaliteti shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar në dobi të Bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të saj.
2. Personaliteteve të shquara që kanë dhënë kontribut të spikatur dhe që kanë lënë gjurmë në Bashkinë e Vlorës.
3. Qytetarë të Vlorës që kanë dhënë kontribut të shquar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Akordimi i këtij titulli bëhet në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.94/2022 datë 22.12.2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

b) “Titull i veçantë vendorë i nderit”

1. Këshilli i Bashkisë ka të drejtë të krijojë dhe të japë jo më shumë se 2 (dy) tituj të veçantë vendorë nderi në një vit kalendarik, për të shprehur mirënjohjen e posacme për veprimtarinë e shquar në dobi të komunitetit të saj.
2. Titujt e veçantë vendorë të nderit krijohen me vendim të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili përmban:
 - a) Nevojën për nderimin e veçantë;
 - b) Arsyen përse nderimi me titullin “Qytetar Nderi”, sipas pikës 9 të ligjit nr.94/2022, nuk është i përshtetshëm dhe i mjaftueshëm dhe shtetasi i propozuar për nderim duhet dalluar nga shtetasi tjerë;
 - c) Emërtesën e titullit të veçantë vendor të nderit, i cili përkon me një datë ose ngjarje të shënuar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Medaljet që jepen nga Kryetari i Bashkisë:

a) “Personalitet i Qytetit Vlorë”

Kryetari i Bashkisë jep medalje për personalitete të shquara:

- a) Personalitet i shquar në fushën e Arsimit.
- b) Personalitet i shquar në fushën e Shëndetësisë.
- c) Personalitet i shquar në fushën e Letërsisë dhe Arteve.

b) “Mirënjohje e Qytetit Vlorë”

Kjo medalje u akordohet personave fizik apo juridik, vendas ose të huaj që kanë kontribut të shquar, në fushat e ndryshme të jetës: kulturore, historike, sportive, humanitare etj të cilat nuk parashikohen në pikën 2/a.

Neni 8

E drejta e nismës dhe propozimit për dhënien e titujve të nderit

Propozimi për dhënien e Titujve të Nderit mund të bëhet nga :

1. Kryetari i Bashkisë.
2. Prefekti i Qarkut.
3. Cdo anëtarë i Këshillit Bashkiak.

Propozimi për dhënien e medaljeve mund të bëhet nga:

1. Drejtues të institucioneve rajonale.
2. Organizata jofitimprurese vendase ose të huaja.
3. Drejtues te Institucioneve arsimore dhe kulturore.

Neni 9

Procedura e propozimit dhe dokumentacion shoqërues për titullin e nderit që miratohet nga Këshilli i Bashkisë

1. Propozimi duhet të dërgohet jo më vonë se 90 ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e titullit në sekretarinë e Këshillit Bashkiak, me përjashtim të rasteve të veçanta kur respektimi i këtij afati është bërë objektivisht i pamundur.

2. Në aktin e propozimit përcaktohen :

- a) autoriteti propozues dhe baza ligjore për propozimin.
- b) Emri, Mbiemri dhe një prezantim të personit të propozuar (duhet të disponojë edhe foto);
- c) arsyet e hollësishme që çojnë në propozimin e personit;
- d) vërtetimi se personi i propozuar nuk është dënuar ndonjëherë për shkelje të rënda të ligjit ose nuk është nën hetim;
- e) llojin e titullit vendor të nderit ose medaljes që propozohet.
- f) letër rekomandimi nga një institucion i të njëjtës linjë me të cilin është i lidhur aktiviteti profesional apo njerëzor i personit të propozuar;
- g) materiale dokumentuese që dëshmojnë për arritjet e personalitetit gjatë jetës së tij, si botime, çertifikata, diploma, fletë falenderimi ose mirënjohje etj, të cilat ndihmojnë këshilltarët të kenë një informacion më të plotë të propozimit për dhënien e titullit;

h) deklaratë për personit e propozuar që nuk i është akorduar më parë një titull tjetër i nivelit më të lartë se ai vendor;

i) çdo propozim për dhënie titulli duhet të shoqërohet me motivacionin përkatës në mënyrë të përmbledhur, motivacioni i cili rishqyrtohet nga komisioni përkatës.

3. Në rastin kur nisma ndërmerret kryesisht nga Këshilli i Bashkisë, është i mjaftueshëm dokumentacioni nga germa b deri në germën i të pikës 2 të këtij neni.

Neni 10

Procedura e shqyrtimit të propozimit

1. Sekretaria e Këshillit të Bashkisë propozimin për titullin vendor të nderit sipas pikës 1 të nenit 8, brënda 5 ditëve kalendarike janë përcjell për shqyrtim Komisionit Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit.

2. Komisioni Këshillimor verifikon nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementët e procedurës dhe dokumentet shoqëruese.

3. Në rastin kur Komisioni vëren mangësi në dokumentacion ose kërkon informacion shtesë, propozuesit i kërkohet plotësimi i dokumentacionit brënda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së propozimit, plotësimi i tij nga autoriti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

4. Nëse propozimi është i plotë, Komisioni paraqet mendimin e tij me shkrim para Këshillit Bashkiak brënda 30 ditëve nga data e marrjes së propozimit.

5. Procedurat për shqyrtimin e dhënies së një titulli nderi nuk mund të zgjasin më shumë se 60 ditë kalendarike.

5. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dhënies së titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 11

Miratimi i propozimit

1. Propozimi miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak i cili është autoriteti përgjegjës për miratimin ose jo të propozimit për dhënien e titullit të nderit.

2. Votimi për dhënien e titujve të nderit bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

3. Me vendim të Kryetarit të Bashkisë për medaljet dhe çertifikatat e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 12

Refuzimi i propozimit

Propozimi refuzohet kur:

1. Kur propozimi për dhënien e titullit vendor të nderit ose medaljes nuk miratohet, Komisioni Këshillimor për dhëniën e titujve vendor të nderit në Bashkinë Vlorë bën njoftimin autoritetit propozues për mosmiratim.

2. I njëjti propozim nuk mund të bëhet pa kaluar 1 vit kalendarik nga njoftimi i refuzimit të propozimit.

Neni 13 **Çertifikata e akordimit te titullit**

1. Çertifikata për akordim titujve është e formatit A4 dhe shoqërohet me simbolet e qytetit.
2. Çertifikatat për titujt e aprovuar nga Këshilli Bashkiak nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe vuloset me vulën e Bashkisë Vlorë.
3. Çertifikatat për titujt e aprovuar nga Kryetari i Bashkisë nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe vuloset me vulën e Bashkisë Vlorë.
4. Në çdo rast çertifikata shoqërohet me një medalje sipas specifikime të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14 **Ceremonia e dhënies së titullit**

1. Ceremonia e dhënies së titullit organizohet nga institucioni propozues në bashkëpunim me sekretarinë e Këshillit Bashkiak brënda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.
2. Dhënia e titullit bëhet me ceremoni publike / jopublike.
3. Titujt e nderit e jep kryetari i Këshillit Bashkiak ose persona te autorizuar nga ai si dhe nga Kryetari i Bashkisë (për titujt e propozuar prej tij).
4. Titulli i nderit i jepet personit të cilit i akordohet. Në rast dhënie titulli pas vdekjes, titulli i jepet familjarëve të personit.
5. Si rregull, dhënia e titulli duhet të jetë e lidhur me përvjetorë të ngjarjeve të rëndësishme historike, kulturore si dhe me festat kombëtare.
6. Çasti i dorëzimit të titujve të nderit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht, nëpërmjet të njëjtit akt me të cilin është dhënë fillimisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dhënies së titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 15 **Evidentimi i titujve të nderit**

1. Titujt vendor të nderit që jepen nga Këshilli Bashkiak evidentohen në një regjistër të veçantë, i cili administrohet nga sekretaria e Këshillit Bashkiak.

2. Titujt e nderit ose medaljet që jepen me vendim të Kryetarit të Bashkisë evidentohen në regjistrë të veçantë nga Sektori i Ceremonive dhe Pritjeve Zyrtare të Bashkisë Vlorë.

Neni 16

Emërtimi i Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë

1. Këshilli i Bashkisë është organ vendimmarrës për emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë dhe udhëhiqet nga parimi i vlerësimit të kontributit, meritokracisë dhe mirënjohjes publike në vendimmarrjen e tij.
2. Gjatë procedurës së emërtimit vlerësohen personalitete të shquara me kontribut të spikatur në nivel lokal dhe kombëtar si dhe ngjarje me rëndësi në historinë e qytetit të Vlorës si dhe në nivel kombëtar. Mund të emërtohen edhe me emra të personaliteteve të huaja të cilat kanë kontribut në promovimin e interesave të Kombit Shqiptar ose qytetit të Vlorës.

Neni 17

E drejta e propozimit për emërtimi i Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë

1. Propozimi për dhënien e Titujve të Nderit mund të bëhet nga :
 1. Kryetari i Bashkisë.
 2. Prefekti i Qarkut.
 3. Cdo anëtarë i Këshillit Bashkiak.
 4. Organizata jofitimprurëse në nivel kombëtar.

Neni 18

Procedura e shqyrtimit të propozimit për emërtimi i Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë

1. Procedura e propozimit dhe shqyrtimit të tij për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë realizohet sipas parashikimeve të nenit 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje për sa nuk bie në kundërshtim me objektin e vendimmarjes së Këshillit të Bashkisë.

2. Propozimi për vendimmarje në Këshillin e Bashkisë shoqërohet me një relacion dhe dokumentacion shoqërues nga Drejtoria e Urbanistikës ku përcaktohet vendodhja e objektit që emërtohet.

3. Vendimi i Këshillit të Bashkisë miratohet bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 139.2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Neni 19 **Intepretimi i Rregullores**

1. Kur ngrihen pretendime lidhur me intepretimin ose zbatimin e kësaj rregulloreje, ose për çështje të paparashikuar në të, Komisioni Këshillimor, Kryetari i Këshillit dhe Këshilli i Bashkisë përdorin si referencë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Në raste të tjera, kërkesa mund të paraqitet për interpretim nga Komisioni Juridik, Rendit dhe Sigurisë Vendore si dhe Komisioni i Mandateve dhe Rregullores së Këshillit të Bashkisë.

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore pas miratimit të Këshillit të Bashkisë hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

